

progetto cofinanziato dall'Unione Europea



UNIONE EUROPEA



AUTORITA' RESPONSABILE

FONDO ASILO, MIGRAZIONE E INTEGRAZIONE (FAMI) 2014-2020

Progetto



Tuscany Empowerment Actions for Migrants System



ISTITUTO STATALE DI ISTRUZIONE SUPERIORE "Leopoldo II di Lorena"

Via de Barberi - 58 100 Grosseto Tel. 0564/484821 - Fax 0564/415389
Via Meda – Giolitti 58100 Grosseto telefono 0564/484881 - fax 0564/484882
E - mail: gris00600c@istruzione.it - PEC: gris00600c@pec.istruzione.it
www.istplorena.eu



INFORMACIONE PËR PRINDRIT

Të nderuar prindër,

Drejtoresha dhe personeli i shkollës Istituto "Leopoldo II di Lorena" ju faleminderojnë që keni zgjedhur shkollën tonë dhe kemi nderin që t'ju mirëpresin.

Qëllimi ynë i përbashkët është rritja personale dhe suksesi akademik i fëmijëve tuaj. Për këtë arsye është e rëndësishme t'i kushtohet vëmendje asaj që është shkruar më poshtë:

REGJISTRI ELEKTRONIK

Është e rëndësishme të përdorni regjistrin elektronik, ku do të gjeni informacione mbi progresin edukativ-disiplinor të nxënësive, mungesat, komunikimet e mësuesve, informacione mbi kurset përmirësuese, daljet arsimore dhe më shumë.

Për të hyrë në faqen e internetit të shkollës, shtypni www.scuoletoscane.it, klikoni në simbolin e institutit tonë dhe futeni në zonën e rezervuar duke shtypur emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin që Zyra e Studentëve ju ka dhënë në kohën e regjistrimit.



Login: Password: Përdoruesi përbëhet nga mbiemri dhe emri i nxënësit dhe fjalëkalimi është data e tij / saj e lindjes : **p.sh. rossipaolo – 07052004**. Pas lidhjes së parë, fjalëkalimi mund të ndryshohet nëse dëshironi.





UNIONE EUROPEA



AUTORITA' RESPONSABILE

TEKSTET SHKOLLORE

Në faqen kryesore në të djathtë, te ikona INFO do të gjeni informacione mbi tekstet shkollore të klasës të fëmijut tuaj dhe, nga tetori në vazhdim, do të gjeni orët e zyrës së profesorëve. Lista e teksteve shkollore është në dispozicion edhe në të gjitha libraritë e krahinës. Pas publikimit të njoftimit në faqen e shkollës, kush i ka të ardhurat ISEE të ulëta, mundet t'i kërkoj hua për përdorim, Comodato d'uso, domethënë me hua falas.,

Për të paraqitur kërkesën, familja do të duhet të hyjë në faqen e internetit me kredencialet e saj dhe pastaj të klikojë në: • Studenti • Comodato • Domanda (në shiritin e sipërm). Pastaj plotësohen të gjitha fushat dhe bashkangjitet ISEE i azhurnuar në vitin aktual.

MUNGESAT

Ju lutemi vini re se, me ligj, nuk mund të bëhen më shumë se 50 ditë mungesë, e barabartë me përafërsisht 225 orë.

Ky numër i mungesave mund të tejkalohet vetëm për arsye të rëndësishme, të cilat janë: certifikatat mjekësore për sëmundje të rënda, certifikatat për aktivitete sportive dhe, për studentët e huaj, udhëtimi në vendin e origjinës për arsye familjare ose leje qëndrimi.

Për këtë arsye dhe në interes të fëmijëve tuaj, ju lutemi të:

- Njoftoni shkollën për çdo ndryshim në numrin e telefonit celular të të dy prindërve
- Kontrolloni rregullisht për mungesa dhe, nëse është e nevojshme, flisni me koordinatoren e klasës
- Arsyetoni menjëherë mungesat e fëmijës tuaj me PIN që do t'ju jepet nga Zyra e Nxënësve ose nga drejtuesi i kompleksit.
- Shmangni, me përjashtim të arsyeve të vlefshme, hyrjen vonë ose largimin e hershëm nga shkolla, sidomos kur ka shumë detyra në klasë dhe shumë pyetje.

VLERËSIME

Viti shkollor është i ndarë në tre dhe pesë muaj dhe shkolla do të publikojë dy karta raporti: një në janar dhe një në qershor. Në Mars do të ketë gjithashtu një raport për t'ju informuar për përparimin e fëmijës tuaj përpara rezultateve përfundimtare.

Për të parë kartat e raportit, duhet të shkoni në Agenda→Curriculum Vitae→Pagella scolastica. Nëse ka mangësi, kontrolloni gjithashtu kurset përmirësuese të caktuara dhe temat e treguara nga mësuesit për t'u rikuperuar.

Shkolla organizon kurse përmirësuese verore për disa lëndë. Pastaj do të duhet të kryhet një test verifikimi.

DALJE DIDAKTIKE



progetto cofinanziato dall'Unione Europea



UNIONE EUROPEA



AUTORITA' RESPONSABILE

Shkolla shpesh organizon dalje didaktike, udhëtime arsimore dhe kurse gjuhe jashtë vendit gjatë vitit. Familjet do të informohen përmes faqes dhe do të duhet të nënshkruajnë një autorizim. Gjatë udhëtimeve shkollore, studentët që nuk marrin pjesë duhet të ndjekin rregullisht mësimet.

PRAKTIKA

PCTO-ja, Rrugët për aftësitë transversale dhe orientimin, është një projekt që lejon studentët e instituteve teknike dhe profesionale të njohin nga afër botën e punës, falë një praktike e bërë në një nga ndërmarrjet e zonës tonë. Midis vitit të tretë dhe të pestë të shkollës së mesme, orët e PCTO-së janë gjithsej 400.

CELULARËT

Sipas ligjit, celularët mund të çohen në shkollë, por ato duhet të fiken. Telefonat celularë mund të përdoren për qëllime arsimore ose, përjashtimisht, me autorizimin e mësuesit. Përdorimi i pahijshëm mund të çojë në një shënim disiplinor dhe tërheqjen e telefonit celular, i cili do t'i kthehet prindit nga drejtuesi i kompleksit.

LABORATORËT

Studentët tanë do të jenë në gjendje të kryejnë aktivitete të shumta në laborator. Një listë do t'i jepet sekretarisë me informacion mbi uniformën për të blerë për të hyrë në laboratorë. Përdorimi i uniformës në laborator është i detyrueshëm.

PRITJA E PRINDËRVE

Të gjithë mësuesit janë në dispozicion, një orë në javë, për biseda me prindërit. Koha tregohet në klasat INFO në faqen e internetit. Ka edhe dy pritje të përgjithshme pasdite, një në dhjetor dhe tjetri në prill.

ZYRA E NXËNËSVE



Për të komunikuar me Zyrën e Nënësve është e nevojshme të rezervoni një takim duke telefonuar në 0564/484821 ose duke klikuar në simbolin e mësipërm, në faqen kryesore.

Personat e kontaktit të Institutit tonë:



progetto cofinanziato dall'Unione Europea



UNIONE EUROPEA



AUTORITA' RESPONSABILE

Direttrice e scollès
Zëvendësdirjtor
Koordinatori selia Cittadella
Koordinatori selia via Meda

Prof.ssa Cinzia Machetti
Prof.ssa Roberta Cavallini
Prof.ssa Laura Bugelli
Prof. Angelo Valentino e prof.ssa Mariolina Rispoli

Numrat e dobishëm të telefonit:

Shkëmbim telefonik selia Cittadella
Shkëmbim telefonik selia via Meda

Tel 0564/484821
Tel 0564/484881

UDHËZIME PËR KLASAT E PARA

Për t'u regjistruar në vitin e parë të shkollës sonë duhet të klikoni në butonin "Regjistrimi në klasat e para" ("Iscrizioni alle classi prime") në faqen kryesore. Në kohën e regjistrimit do të duhet të sillni me vete:

- fotokopjen e kartës së identitetit të studentit;
- fotokopjen e kodit tatimor të studentit;
- fotokopjen e certifikatave të vaksinimeve të kryera;
- certifikata e licencës së klasës së tetë;
- diagnoza e mundshme dhe Plani i personalizuar i nëxënësit DVA ose DSA;
- faturë pagese prej 70 € (kontribut vullnetar 62 € dhe sigurim i detyrueshëm i aksidenteve prej 8 €).

